



Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Prishtinë, më 2 gusht 2013

Z. Heset Loku, drejtor
Qendra Korrektuese për Femra dhe të Mitur në Lipjan
Lipjan
10000 Prishtinë

RAPORT SPECIAL

në lidhje me Ankesën 363/2013, Shefqet Miftari

kundër

Qendrës Korrektuese për Femra dhe të Mitur në Lipjan

Avokati i Popullit, në bazë të nenit 15.1, të Ligjit për Avokatin e Popullit, nr. 03/L-195, më 16 janar 2013, ka pranuar ankesën e z. Shefqet Miftari (në tekstin e më tejme: *ankuesi*), e cila ka të bëjë me keqtrajtimin fizik të djalit të tij GM (GM tani i ndjerë), nga oficerët korrektues në Qendrën Korrektuese për Femra dhe të Mitur (QKFM) në Lipjan, si dhe për trajtim joadekuat shëndetësor.

Sipas pohimeve të ankuesit, djali i tij – GM, i lindur në vitin 1996, ishte arrestuar nga Policia e Kosovës në muajin tetor 2012, për veprën penale grabitje dhe më pas ishte dërguar në paraburgim në QKFM në Lipjan. Për shkak të përkeqësimit të gjendjes shëndetësore, si pasojë e ngjarjeve që i kishin ndodhur në QKFM në Lipjan, më 10 dhjetor 2012, GM ishte dërguar për trajtim shëndetësor në Qendrën Klinike dhe Universitare të Kosovës (QKUK). Sipas ankuesit, GM gjatë qëndrimit në QKMF në Lipjan ishte keqtrajtuar nga ana e oficerëve korrektues dhe nga personeli shëndetësor dhe se tani ishte në gjendje shumë të rëndë shëndetësore.

Më 17 janar 2013, përfaqësuesit e Institucionit të Avokatit të Popullit (IAP) realizuan një vizitë në QKFM në Lipjan dhe biseduan me punëtorët socialë të kësaj qendre. Sipas deklaratave të punëtorëve socialë, gjatë qëndrimit në QKFM në Lipjan, GM ishte vizituar disa herë nga ata. Fillimisht gjendja shëndetësore e tij kishte qenë stabile, mirëpo pas disa javësh ajo kishte ndryshuar.

Për shkak të përkeqësimit të gjendjes shëndetësore, ai në dhjetor të vitit 2012 ishte hospitalizuar në QKUK. Më 16 janar 2013, punëtorët socialë të QKFM-së në Lipjan e kishin vizituar GM, në QKUK për t'u informuar nga afër me gjendjen e tij shëndetësore dhe trajtimin që po i bëhej. Nga analizat dhe raportet mjekësore, të pranuar nga QKUK, ata kishin vërejtur se GM vuante nga një sëmundje e rëndë dhe e pashërueshme. Një konstatim i tillë ishte bërë nga ana mjekut kompetent të QKUK-së. Sipas deklaratave të punëtorëve

socialë, pretendimet e ankuesit për keqtrajtim fizik dhe shëndetësor të GM nga personeli i QKFM-së në Lipjan, janë të paqëndrueshme.

Më 12 korrik 2013, përfaqësuesi i IAP-së ishte takuar me përfaqësuesen e Shërbimit Sprovues të Kosovës (SHSK), e cila kishte punuar në rastin e GM në kohën kur i mituri GM ishte në liri. Ajo kishte deklaruar se GM e kishte vizituar edhe në kohën kur ai ishte në QKFM në Lipjan, në QKUK, dhe së fundmi para disa ditësh në familje. Sipas saj, i mituri GM disa herë kishte pasur probleme me ligjin dhe për disa vite me radhë kishte qenë nën mbikëqyrjen e saj si zyrtare e SHSK-së. Më tutje, ajo kishte deklaruar se gjatë vizitës në QKFM në Lipjan, kishte vërejtur se gjendja shëndetësore e GM nuk ishte e mirë.

Lidhur me gjendjen e rëndë shëndetësore të GM përfaqësuesja e SHSK-së ishte njoftuar edhe nga familjarët e GM të cilët e kishin informuar atë se GM pas qëndrimit për një kohë në Klinikën Psikiatrike dhe në atë Neurologjike të QKUK-së, ishte lëshuar nga spitali në gjendje shumë të rëndë shëndetësore, me arsyen se mjekët nuk kanë çfarë të bëjnë për shëndetin e tij.

Më 16 korrik 2013, përfaqësuesit e IAP-së, përmes mediave elektronike (portali infoGLOB) u informuan se GM kishte vdekur. Në shkrimin e botuar në portalin e lartpërmendur citoheshin edhe disa pretendime të familjarëve se përkeqësimi i gjendjes shëndetësore të fëmijës së tyre kishte ardhur si pasojë e keqtrajtit të tij nga oficerët korrektues dhe terapisë joadekuate, të dhënë nga mjeku i QKFM-së në Lipjan.

Më 16 korrik 2013, përfaqësuesit e IAP-së realizuan një vizitë në QKFM në Lipjan, me qëllim të informimit më të hollësishëm me rastin e GM. Qëllimi i kësaj vizite ishte të hetohet se cila ishte gjendja shëndetësore e GM në momentin e pranimit dhe lëshimit nga QKFM në Lipjan, faktorët që kishin sjellë në përkeqësimin e gjendjes shëndetësore, si dhe të vërtetimit nëse ka pasur lëshime në punën e stafit profesional menaxhues dhe stafit të përgjithshëm të QKFM-së në Lipjan, lidhur me këtë rast.

Vizita në QKFM në Lipjan, më 16 korrik 2013

Fillimisht përfaqësuesit e IAP-së u takuan me drejtorin e QKFM në Lipjan, të cilin e informuan, lidhur me qëllimin e vizitës dhe më pas me udhëheqës të Pavijonit të Pranimit dhe Mbikëqyrjes, ku u informuan gjerësisht me përmbajtjen dhe dokumentet në dosjen e GM

- Nga raporti i pranimit vërehet se GM është pranuar në QKFM në Lipjan më 10 tetor 2012 në orën 15:25 dhe në bazë të kontrollimit mjekësor nuk është vërejtur ndonjë lëndim trupor, nuk vërehet se ka pasur ndonjë problem shëndetësor dhe një gjë e tillë nuk është deklaruar nga GM. Po ashtu QKFM në Lipjan nuk ka pranuar ndonjë dokument përcjellës i cili do të tregonte se ky person ka pasur ndonjë sëmundje të mëhershme.
- Më 11 tetor 2012, GM është vizituar nga zyrtarja sociale e QKFM në Lipjan e cila ka biseduar me të dhe në bazë të raportit të saj, nuk vërehet ndonjë shqetësim nga GM dhe ajo nuk ka pranuar ndonjë ankesë nga ai.
- Më 11 tetor 2012, GM është vizituar nga psikologjia e QKFM në Lipjan dhe në bazë të mendimit të saj të dhënë në raport, është cekur se tek GM vërehet një labilitet psikologjik.
- Më 18 tetor 2012, GM është vizituar nga dy zyrtare të Shërbimit Sprovues të Kosovës të cilat kanë zhvilluar një bisedë me të miturin.
- Më 29 tetor 2012, GM është vizituar nga zyrtarja sociale e QKFM në Lipjan dhe në bazë të raportit i cili po ashtu gjendet në dosje të lëndës, është cekur se GM është në gjendje të mirë dhe është i hapur në bisedë edhe në këtë rast ai nuk ka paraqitur ndonjë ankesë. Po ashtu në raport ceket se GM ka deklaruar para zyrtares sociale se gjatë kohës sa kishte qenë në liri ai kishte vizituar disa herë OJQ “Terres Des Hommes” dhe kishte pasur takime me psikologun e kësaj OJQ.

- Më 9 nëntor 2012, zyrtarja sociale e QKFM në Lipjan e ka vizituar GM dhe në raport është cekur se GM ka jo stabilitet dhe mos orientim të duhur në hapësirë.
- Më 26 nëntor 2012, GM është vizituar nga mjeku dhe në bazë të raportit që ishte në dosje vërehet se GM i është caktuar terapia Vitaminë-C 2x1.
- Më 30 nëntor 2012, GM është vizituar nga mjeku dhe tek ai është vërejtur një çrregullim depresiv, humbje e apetitit, mërzitje, dobësim i të pamurit dhe atij i është caktuar një terapi tjetër Bencidin 5 mg 0+0+1 dhe Beviflex 8 mg 1+0+1 dhe i është rekomanduar kontrolli mjekësor pas 7 ditëve.
- Më 6 dhjetor 2012, GM është vizituar nga mjeku dhe i është caktuar kjo terapi: Vitaminë-C dhe Beviflex.
- Më 7 dhjetor 2012, GM është vizituar përsëri nga mjeku dhe i është caktuar terapia: Floxektin, Diazepam dhe Beviflex.
- Në bazë të raportit mjekësor vërehej se, GM më 10 dhjetor 2012 është Hospitalizuar në QKUK.
- Nga dokumentacioni që ishte në dosje të tij, vërehej se më 10 dhjetor 2012, QKFM në Lipjan e ka njoftuar Gjykatën Komunale në Prishtinë për gjendjen shëndetësore të GM dhe kishte kërkuar nga gjykata që GM t'i ndërpritet masa e paraburgimit, kërkesë të cilën QKFM në Lipjan e kishte përsëritur edhe më 11 dhjetor 2012.
- Po ashtu më 14 janar dhe 17 janar 2013 QKFM në Lipjan e ka njoftuar Gjykatën Themelore në Prishtinë për gjendjen e rënduar shëndetësore të GM dhe kishte përsëritur kërkesën për lirim të tij nga masa e paraburgimit, gjë të cilën gjykata e ka bërë më 18 janar 2013.
- Pas kontrollimit të dosjes së GM, përfaqësuesit e IAP kontrolluan në tërësi librin e kujdestarisë së pavijonit ku ka qëndruar GM dhe atë nga data e pranimit deri në ditën e lëshimit të tij nga QKFM në Lipjan. Nga të dhënat e shënuara në libër, në asnjë rast nuk është evidentuar se ka pasur ndonjë incident në mes të GM dhe ndonjë të mituri tjetër të burgosur, apo ndonjë incident në mes të tij dhe oficerëve korrektues.

Më 18 korrik 2013, përfaqësuesi i IAP ishte takuar me përfaqësuesit e OJQ “Terre Des Homme” (TDH), përkatësisht me psikologun, i cili e kishte trajtuar dhe përcjellë rastin e GM që nga dita e pranimit e deri në vizitën e fundit në QKFM. Ai i kishte dorëzuar përfaqësuesit të IAP-së raportin për rastin e GM, me këto të dhëna:

- Sipas raportit të pranuar nga TDH, rasti i GM, fillimisht ishte referuar në Tryezën e Rrumbullakët për Menaxhimin e Rasteve (TMR) në Shtator të vitit 2010 nga Qendra për Punë Sociale (QPS) në Prishtinë, me arsyetimin: ikje nga shtëpia, shoqërim me grupe madhore, vepra të kundërligjshme, vjedhje etj. Pas vlerësimit të rrezikut, ky rast ishte pranuar si rast i TMR dhe në bazë të planit të veprimit ishte vendosur që Psikologu i TDH të ndihmojë punëtoreshën sociale të QPS, me qëllim që të fillohet me këshillimin psikologjik të GM dhe përmirësimit të sjelljeve të tij dhe rregullimit të marrëdhënieve mes GM dhe familjes.
- Vizitat e para me GM kanë qenë të vështira për t'i realizuar pasi që GM shpesh herë nuk gjendej në shtëpi dhe kishte pasur raste kur me ditë të tëra nuk kthehej në shtëpi. Po ashtu, në fillim GM kishte rezistuar të fliste me psikologun, por pas një kohe ai kishte filluar të komunikojë me psikologun.
- Prindi i GM i kishte pohuar psikologut se djali i tij ishte arrestuar nga policia disa herë dhe kishte pas raste kur ishte keqtrajtuar fizikisht, mirëpo për këto pohime ai nuk kishte sjellë kurrfarë dëshmie mjekësore edhe pse një gjë e tillë ishte kërkuar nga psikologu.
- Nga simptomat që kishte hasur tek GM, psikologu i TDH i kishte rekomanduar prindit të tij që GM të bëjë një vizitë tek OJQ “Labyrinth”, për të bërë analizat dhe testin nëse ai ishte përdorues i substancave narkotike. Edhe pse në fillim kishin pranuar, një gjë e tillë nuk

ishte realizuar pasi që GM kishte refuzuar me arsyetimin se është në gjendje të mirë shëndetësore dhe nuk ka nevojë për analiza. Po ashtu, pas disa seancave këshilluese, GM i kishte deklaruar psikologut të TDH se nuk ka nevojë më për këshilla.

- Një nga zyrtarët e SHSK e kishte informuar psikologun e TDH se i mituri GM ka bërë gjithsejtë 40 vepra të vjedhjes, dhe se në mesin e tyre ka edhe vjedhje të rënda dhe nëse kjo vazhdon, GM së shpejti mund të privohet nga liria dhe të dërgohet në QKFM në Lipjan, gjë e cila ka ndodhur në tetor të vitit 2012. Pas njoftimit të TMR, se i mituri është dërguar në QKFM në Lipjan dhe duke pasur parasysh faktin se trajtimi shëndetësor, psikologjik, dhe psikosocial ofrohet edhe në QKFM në Lipjan, është vendosur që rasti i të miturit GM të mbyllet.
- Psikologut të TDH, gjatë muajit nëntor 2012, i kishte ardhur një ftesë nga gjykata përmes së cilës kërkohet që ai të vizitojë GM në QKFM në Lipjan, me arsyetimin se GM nuk ishte në gjendje të mirë shëndetësore dhe kishte kërkuar të bisedojë vetëm me të.
- Së bashku me punëtorin sociale të QPS në Prishtinë, psikologu i TDH kishte vizituar GM në QKFM në Lipjan, i cili kishte deklaruar se është mërziur dhe nuk dëshironte të fliste me askë. Sipas psikologut, gjendja shëndetësore e GM ishte brengosëse, sepse ai fliste me vështirësi. Gjatë kësaj vizite, psikologu i TDH kishte pasur një konsultim edhe me punëtorin sociale të QKFM në Lipjan dhe u kishte rekomanduar që i mituri të dërgohet për trajtim shëndetësor në QKUK dhe t'i bëhen analizat e gjakut.
- TDH nuk kishte pasur ndonjë kontakt tjetër me familjen apo të miturin GM deri më 14 korrik 2013, me ç'rast TDH është njoftuar nga SHSK me një kërkesë të familjarëve të GM. Familja kërkonte mbështetje financiare për mbulimin e shpenzimeve për medikamente për GM, i cili ishte diagnostifikuar me sëmundje të rëndë dhe kishte nevojë për ndihmë. Pas këtij njoftimi TDH i kishte ofruar ndihmë familjes së GM në sigurimin e medikamenteve mjekësore.

Konstatimi i Avokatit të Popullit

Avokati i Popullit, pas vlerësimit të të dhënave nga dosja e rastit dhe informatat e siguruara lidhur me rastin, vëren se nuk ka pasur ndonjë lëshim profesional në trajtimin e të miturit GM, nga ana e stafit menaxhues dhe profesional të QKFM në Lipjan. Bazuar në dëshmitë dhe informatat e pranuar, Avokati i Popullit gjithashtu nuk ka mundur të konkludojë se ka pasur ndonjë keqtrajtim fizik apo trajtim joadekuat mjekësor të GM, gjatë qëndrimit të tij në QKFM në Lipjan.

Avokati i Popullit e kupton dhimbjen që ka familja për humbjen e të birit dhe me këtë rast shprehë ngushëllimet më të sinqerta për vdekjen e tij, mirëpo dyshimet dhe akuzat e ngritura në media për keqtrajtim fizik dhe trajtim joadekuat shëndetësor të GM nga QKFM nuk qëndrojnë.

Nga ajo që u tha më lart, Avokati i Popullit konkludon se nuk ka pasur ndonjë shkelje të të drejtave të personit të privuar nga liria apo ndonjë veprim, i cili do të paraqiste shkelje të nenit 27 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përkatësisht të nenit 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nga ana e QKFM në Lipjan. Përkujdesja shëndetësore, trajtimi psikosocial i GM nga QKFM, në Lipjan ka qenë në përputhje me obligimet që dalin nga neni 45 i Ligjit mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale dhe të gjitha normat ligjore në fuqi.

Me nderime,

Sami Kurteshi
Avokat i Popullit

Kopje: Z. Hajredin Kuçi, ministër në Ministrinë e Drejtësisë.
Z. Shemi Haziri, u.d. drejtor i përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës.